



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.269/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se postereve në afërsi se qendrës së votimit 100 m, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.269/2017 e datës 12.06.2017, e Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë për **Koalicioni PDK-AAK-NISMA**.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatja për deputete Luljeta Vitia Gutaj, nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka shpërndarë fletëvotime më kartë vizita në emër të saj. Ky veprim i subjektit në fjalë sipas pretendimeve në ankesë në kuptim të dispozitivit të nenit 213 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me nr 04/L-082, paraqet cenim të përcaktimit të lirisë të votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Sepse nga ankesa e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se në cilin vende është shfaqur kjo shkelje e heshtjes zgjedhore dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të përfituar vota në atë Qendër të Votimit, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.269 /2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*

